

STATUT

I SHOQËRISE "ARVI INVEST"

Sot ne dt. **08 Shkurt** 2021 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",
ERVIS IMERAJ , i biri i **ARJAN** i datelindjes **20-01-1988**, i lindur ne Fier dhe banues
Fier,lagj. **KONFERENCA E PEZES FIER**, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike
dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.Personal
,leshuar ng **I80120084A** a MB Tirane me date **14-10-2020**,
me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne
Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date
14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin
Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me
emertimin "**ARVI INVEST**" .

KREU I

Krijimi,Personaliteti juridik,Selia

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **ARVI INVEST**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me
pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te
Biznesit , në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për
detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **ARVI INVEST**., eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që
themelohet nga ortakut i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së
kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagja , Rr Mujo Ulqinaku,Nd.39,H7,Fier,9305

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte
filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te
Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

**Te shtojte veprimtarine e biznesit ne fushen e ndertimit te objekteve
rezidenciale dhe jorezidenciale. Rikonstruksion objektesh. Germime dheu dhe
kanalizime. Shtrim i linjave te ujesjellesit, gazsjelles. Shtrim dhe asfaltim
rrugesh.Transport i produkteve dhe mallrave industriale, makineri e pajisje,
per vete dhe per te tretet. Import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice i
mjeteve dhe artikujve te ndryshem industriale.
Transport mallrash me mjete jashte norme.**

Neni 5

Kohezqatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke
filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI



Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.
Kapitali i shoqerise eshte 100,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i shoqerise si me poshte :
-Ortaku Themelues: **ERVI IMERAJ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme **100,000** Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise
Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **100,000 Leke**
Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **100,000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ne ortaku.
Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.
Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.
Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblese se ortakeve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.
Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.
Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar to shoqerise. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve to kapitalit qe perfaqesojne.
Vendimi lidhur me kapitalin i njoftohet Qendres Kombetare te Biznesit per regjistrim nga administratori ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723 date 03.5.2007"Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me pelqimin e Ortakut te Vetem Themelues te shoqerise. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.



Asambleja e Ortakut te vetem eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i Ortakut te Vetem Themelues ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Asambleja e ortakeve mund te thirret nga Ortaku i vetem themelues, nga administratori, nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likuiduesi.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, te hartuara nga administratori.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e Ortakut te vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem, i cili do te jete **ERVIS IMERAJ**, i biri i **ARJANIT**, i datelindjes 12-09-1988, i lindur ne Fier dhe banues Fier, lagj. **KONFERENCE PEZES.FIER.**, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr. Personal ,leshuar **I80120084A** nga MB Tirane me date 14-10-2020

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec kesaj, administratoret shkarkohen nga gjykata per shkeje te ligjit me kerkese te Ortakut te Vetem Themelues. Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Biznesit. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

Neni 12
Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asambleja e Ortakut të vetem.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdoq formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Administratori ka të drejte e detyrohet të:

- a) kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- d) përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithshme për miratim.
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryeje regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara Asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblese së ortakëve edhe në rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, tërheqje, transferime etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vëndore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Neni 13
Përgjegjësitë



Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tregëtve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" administratori detyrohet:

1.

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit të prezantuar apo të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregëtare me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në të, administratori është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit, Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) a paguan ortakëve interesat apo dividende;
- c) u shpërndan aktivitetin e shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregëtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi të paguara për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asambleës nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesës për padi kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 15



Bilanci i shoqërise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Asamblese se ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Asambleja e Ortakut te vetem, e cila jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqërise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, Ortakut te Vetem Themelues të shoqërise.

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqërive Tregtare"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper "

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së shoqërise në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të

shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debitore qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil, Ligjin per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita perfundimtare

Ky statut hartohet dhe nenshkruhet ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **ARVI INVEST.**, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I SHOQËRISË

Ervis Jmerzi

